



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 142

Tiranë – E enjte, 6 korrik 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 10560, datë 30.6.2017	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 6903
Dekret i Presidentit nr. 10561, datë 30.6.2017	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 6903
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 75, datë 22.6.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 63, datë 6.7.2016, “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Fondi për Gratë Sipërmarrëse në Bashkinë e Tiranës””..... 6904
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 76, datë 22.6.2017	Autorizim i dhënies së ndihmës shtetërore “Për krijimin e Fondit të Sipërmarrjes Turistike”..... 6904

**DEKRET**

Nr. 10560, datë 30.6.2017

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Punëve të Brendshme, ministrit të Kulturës dhe ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Bajrush Rexhep Zeqiri
2. Krenar Husein Ujkaşi (Ujkashi)
3. Ercan Nazim Sari
4. Şaban Ömer Üçgül
5. Nrec Musë Mehmeti
6. Hacer Zübeyir Arslan (Işler)
7. Afërdita Tahir Meta (Gorqaj)
8. Bajram Hakip Sinani
9. Kimete Nasuf Sinani (Miftari)
10. Engin Hasan Ertaş
11. Bedia Şeref Can (Altin)
12. Benjamas Udom Ounkay
13. Beqir Ejup Parllaku (Parllak)
14. Kemal Hazar Şükrü Göksel
15. Mustafa Salih Bedrettin Ergün
16. Bashkim Safet Zhuri
17. Qamil Rexhep Krasniqi
18. Feriz Ahmet Selimi
19. Antigone Metë Ramosaj
20. Jarina Halid (Halit) Peku (Hasi)
21. Dukagjin Eugen (Eugjen) Cami
22. Bora Ali Zükali
23. Kristo Nikolla Xhima (Tzima)
24. Gjergji Kristo Mihallari
25. Andon Kristo Mihallari
26. Agron Sahit Mustafa

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 10561, datë 30.6.2017

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Mirsad Adem Shkreta
2. Rabije Miftar Mushkolaj (Pajazitaj)
3. Şelçuk Giray Naim Özdamar
4. Özlem Muzaffer Aktürk (Keleş)
5. Rexhep Halit Strelci
6. Idris Ekrem Nuh Erduran
7. Rabije Rexhep Bajrami
8. Time Rustem Kuçana (Tolaj)
9. Gjilizare Abaz Osmani (Alili)
10. Ardian Nexhmedin Shehu
11. Ramazan Cemal Avci
12. Fatma Ahmet Avci (Aktaş)
13. Fitim Hetem Rama
14. Rahman Islam Qeriqi
15. Orkunt Mustafa Yozgat
16. Eleni Dimitrios Nikou
17. Ümmühan Mehmet Emin Soylu (Sevinç)
18. Fitim Sali Krasniqi
19. Murad Yumer Muhamed
20. Gabriela Vasile Kadena (Dumitru)
21. Theodora Ioannis Alexandrou Chatzistraidou
22. Yonus Osman Bozkurt
23. Ceyhun Necmettin Çeşit

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani



VENDIM

Nr. 75, datë 22.6.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 63, DATË 6.7.2016, “PËR PLANIN E DHËNIES SË NDIHMËS SHTETËRORE “FONDI PËR GRATË SIPËRMARRËSE NË BASHKINË E TIRANËS””

Komisioni i Ndhmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- Milva Ekonomi kryetar
- Mimoza Dhëmbi anëtare
- Ahmet Maçellari anëtar
- Petrit Bakiu anëtar
- Gramoz Hoxha anëtar,

në mbledhjen e tij të radhës, të datës 22.6.2017, nëpërmjet Drejtorisë së Tregut të Brendshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore” të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, mori në shqyrtim projektin “Fuqizimi i grave dhe nxitja e sipërmarrjes”. Plani i ndihmës ka si objektiv të mbështesë plane të qëndrueshme biznesi të krijuara nga gratë në Tiranë, të cilat janë të afta të mbijetojnë në një treg konkurrues, i zbatuar në vendimin e KNSH-së nr. 63, datë 6.7.2016.

Duke qenë se objektivi i masës së njoftuar, kostot e pranueshme dhe grupi i përfituesve nuk ndryshon, mbështetur në nenin 19 dhe nenin 22, pika 2, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për Ndhmën Shtetërore”, të ndryshuar

VENDOSI:

1. Të autorizojë planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Fondi për Gratë Sipërmarrëse në Bashkinë e Tiranës” për vitin 2017.

2. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Milva Ekonomi**

VENDIM

Nr. 76, datë 22.6.2017

AUTORIZIM I DHËNIES SË NDIHMËS SHTETËRORE “PËR KRIJIMIN E FONDIT TË SIPËRMARRJES TURISTIKE”

Komisioni i Ndhmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- Milva Ekonomi kryetar
- Mimoza Dhëmbi anëtare
- Ahmet Maçellari anëtar
- Petrit Bakiu anëtar
- Gramoz Hoxha anëtar,

në mbledhjen e tij të radhës të datës 22.6.2017, nëpërmjet Drejtorisë së Tregut të Brendshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore” të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, mori në shqyrtim planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për krijimin e Fondit të Sipërmarrjes Turistike”.

I. Procedura

1. Plani për dhënien e ndihmës shtetërore “Për krijimin e Fondit të Sipërmarrjes Turistike” është njoftuar nga Drejtoria e Mbështetjes së Sipërmarrjes, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (më poshtë MZHETTS), duke respektuar detyrimin për njoftimin e ndihmës në bazë të nenit 20 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

II. Përshkrimi i masës

2. Objektivi. Plani për dhënien e ndihmës ka si objektiv mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (SME-ve), për krijimin e kushteve mbështetëse dhe lehtësuese, përmirësimin e klimës dhe kushteve të prodhimit dhe marketimit të produkteve e shërbimeve turistike, duke krijuar bazat për një zhvillim të sektorit të turizmit. Ndhimja ndikon në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të vendit dhe hapjen e vendeve të reja të punës. Fondi i Sipërmarrjes Turistike u jep ndihmë financiare të drejtpërdrejtë ndërmarrjeve mikro dhe të vogla që operojnë në sektorin e turizmit.



3. Baza ligjore për dhënien e ndihmës janë nenet 4, 5, 6, 7 e 9 të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, të ndryshuar dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 390, datë 3.5.2017, “Për krijimin e fondit të sipërmarrjes turistike”.

4. Kohëzgjatja. Plani i ndihmës parashikohet të fillojë zbatimin në vitin 2017 dhe të zgjasë për një periudhë 3-vjeçare deri në vitin 2019.

5. Dhënësi i ndihmës është Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës është Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

6. Përfituesit. Fondi ka për qëllim dhënien e ndihmës financiare në mbështetje të sipërmarrjeve turistike që zhvillojnë veprimtarinë e tyre si struktura akomoduese të llojit bujtinë në zonat rurale, operatorë turistikë, agroturizëm dhe shërbime kulinare tradicionale të zonës. Sipërmarrjet turistike duhet të jenë ndërmarrje mikro dhe të vogla, që plotësojnë, veçanërisht, kushtet e mëposhtme:

a) Janë ndërmarrje të klasifikuara si mikro ose të vogla, sipas ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme”, të ndryshuar.

b) Kanë selinë ose vendin kryesor të prodhimit brenda territorit të vendit.

c) Ofrojnë shërbime turistike brenda vendit.

d) Paraqesin një projektpropozim ose plan biznesi duke demonstruar se aktivitetet e parashikuara për mbështetje nga Fondi i Sipërmarrjes Turistike janë të rëndësishme për zhvillimin e biznesit të tyre, duke pasur parasysh përdorimin e fondit për një investim afatgjatë.

e) Janë të regjistruara në QKB dhe nuk kanë detyrime tatimore e doganore të papaguara.

f) Operojnë në tregun turistik, jo më pak se 1 vit.

7. Shtrirja territoriale. Projekti do të zbatohet në të gjithë territorin e Shqipërisë.

8. Vlera e ndihmës/Buxheti i planifikuar/Humbjet në buxhet. Fondi total i ndihmës ka një vlerë të përgjithshme prej 30.000.000 (tridhjetë milionë) lekë, për periudhën 2017-2019. Vlera e fondit për secilin vit do të jetë 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i planit të

ndihmës përballohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për ekonominë, e cila krijon një zë të veçantë për këtë qëllim, për llogari të AIDA-s.

9. Në kostot e pranueshme që mund të financohen nga skema përfshihen kostot për:

a) përmirësimin dhe rinovimin e kapaciteteve akomoduese të bujtinave, pajisjeve dhe mobilimeve, bazuar në karakteristikat tradicionale të zonës turistike;

b) përmirësimin e mjediseve e të pajisjeve, në përputhje me trashëgiminë kulturore dhe historike të zonës;

c) përmirësimin e mjediseve e të pajisjeve për përgatitjen dhe shërbimin e ushqimit, në përputhje me standardet e turizmit;

d) certifikimet në përputhje me standardet që zbatohen në sektorin e turizmit.

10. Forma e ndihmës dhe mjetet e financimit. Ndhimja jepet në formën e grantit të drejtpërdrejtë ndërmarrjeve mikro dhe të vogla që operojnë në sektorin e turizmit. Për çdo ndërmarrje përfituese në varësi të projektit konkurrues të përgatitur nga aplikantët, skema mbulon 60-80% të kostove të miratuara, por jo më shumë se 1.000.000 (një milion) lekë.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

11. Vlerësimi i kriterëve që përcaktojnë nëse një masë përbën ndihmë shtetërore do të bëhet bazuar në ligjin 9374/2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, si dhe në praktikën administrative të Komisionit Evropian, jurisprudencën e gjykatave të Bashkimit Evropian, sipas parashikimeve dhe detyrimit që buron nga neni 71, “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Komuniteteve Europiane e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës së aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e komunitetit.”

12. Në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, një masë përbën ndihmë shtetërore



nëse përmbushen, në mënyrë kumulative, të gjitha këto kushte:

- a) aktivizohen burime shtetërore;
- b) përfituesit i jepet një avantazh ekonomik në mënyrë selektive; dhe
- c) shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën;
- d) ka ndikim në tregti.

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohej çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdo lloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara.”

Burimet shtetërore

13. Zbatimi i skemës së njoftuar aktivizon burime shtetërore, sepse financohet direkt nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për ekonominë (MZHETTS).

Bazuar në nenin 2 të ligjit 9374/2005:

“Dhënës të ndihmës shtetërore” janë organet e pushteteve shtetërore dhe të qeverisjes vendore, si dhe çdo ent tjetër që vepron në emër të shtetit, të cilat mund ose janë të autorizuar të japin ndihmë shtetërore.

“Burime shtetërore” janë burimet e buxhetit të shtetit, përfshirë të drejtat dhe detyrimet ndaj të tretëve, titujt shtetërorë, fondet publike, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, burimet e buxhetit të njësisë të qeverisjes vendore, burimet e shoqërive shtetërore, në rastet kur këto burime nuk aktivizohen në përputhje me parimin e investitorit privat në një ekonomi tregu.

Avantazhi ekonomik dhe selektiviteti

14. Skema e ndihmës ka karakter selektiv, sepse prej saj përfitojnë vetëm një numër i kufizuar ndërmarrjesh mikro dhe të vogla, që plotësojnë kushtet e përcaktuara në projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për krijimin e fondit të sipërmarrjes turistike”. Përfituesit e financimit publik kryejnë aktivitet ekonomik në sektorin e turizmit. Skema favorizon ndërmarrje të caktuara kundrejt ndërmarrjeve të tjera. Masa është selektive dhe i jep një avantazh ekonomik përfituesve, pasi ata marrin një ndihmë financiare, që në kushte normale të zhvillimit të veprimtarisë së tyre nuk mund ta siguronin.

Shtrembërimi i konkurrencës dhe efekti në tregti

15. Masa e ndihmës ka potencial për të ndikuar në konkurrencë dhe në tregti, duke qenë se forcon pozitën ekonomike të ndërmarrjeve fituese kundrejt ndërmarrjeve të tjera që operojnë në të njëjtin treg. Zbatimi i skemës do të nxisë zhvillimin e aktiviteteve ekonomike në tregun e turizmit.

Konkluzion

Sa më sipër, duke qenë se skema u jep ndërmarrjeve përfituese një avantazh ekonomik selektiv, financohet direkt nga buxheti i shtetit, ka efekt në konkurrencë dhe tregti, Komisioni vlerëson se masa përbën ndihmë shtetërore.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

Nisur nga të gjitha argumentet e mësipërme, Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson se neni 8 i ligjit 9374/2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, parashikon:

“Ndihma *De minimis* është e lejueshme nëse, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin i jepet një ndërmarrjeje, nuk kalon vlerën maksimale për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.”

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.8.2016, “Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës *De minimis*” përcakton vlerën maksimale të lejuar, si dhe kushtet për autorizimin e ndihmës *De minimis*.

Kreu II i vendimit të KM-së parashikon:

“1. Ndihma lejohet nëse përmbushen, njëherësh, të gjitha kushtet e mëposhtme:

a. Vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje të vetme nuk i kalon 14.000.000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, e llogaritur në përputhje me kushtet dhe parimet e parashtruara në kreun 3 të këtij vendimi.

b. Ndihma është transparente, nëse ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi para dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim risku për konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në kreun 4 të këtij vendimi”.

Kreu III. “Llogaritja e ekuivalentit bruto të grantit”

“1. Granti dhe subvencioni në të holla janë ndihmë transparente.”



Sa më sipër, bazuar në ligjin “Për ndihmën shtetërore” dhe vendimin e KM-së nr. 605/2016, ndihma *De minimis* lejohet nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) Vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarjeje nuk i kalon 14.000.000 (katërbëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh. Ky kusht plotësohet pasi masa konsiston në dhënien e ndihmës financiare të drejtpërdrejtë ndërmarjeve mikro dhe të vogla në **vlerën maksimale prej 1.000.000 (një milion) lekë** për ndërmarje.

b) Ndihma duhet të jepet për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

Kohëzgjatja e të gjithë skemës, e cila është marrë në shqyrtim, është 3 vjet, duke plotësuar dhe kushtin tjetër ligjor.

c) Ndihma është transparente. Granti dhe subsida në të holla janë ndihmë transparente. Në rastin konkret, ndihma jepet në formën e grantit.

Nisur nga të gjitha argumentet e mësipërme, duke qenë në kushtet e përmbushjes së të gjitha kritereve të përcaktuara nga neni 8, Komisioni vlerëson se skema “Për krijimin e Fondit të Sipërmarrjes Turistike” është një skemë ndihme që lejohet.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, 8, 17, 22, dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar:

VENDOSI:

1. Të autorizojë planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për krijimin e Fondit të Sipërmarrjes Turistike”.

2. Çdo plan ndihme, i cili ndryshon masën e ndihmës, lidhur me vlerën, kohëzgjatjen ose kriteret, duhet të njoftohet dhe të marrë miratimin e KNSH-së.

3. Çdo përfitues ndihme duhet të nënshkruajë Deklaratën e Ndihmës *De minimis* (bashkëlidhur) dhe të dorëzojë një kopje të deklaratës pranë AIDA-s dhe një kopje pranë Komisionit të Ndihmës Shtetërore.

4. AIDA, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar.

5. AIDA të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

6. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Milva Ekonomi

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 56 lekë